



MINISTRIA E DREJTËSISË



AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE

AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE

ANALIZA VJETORE E PUNËS PËR VITIN 2017

RAPORT

MBI ANALIZËN VJETORE TË PUNËS PËR VITIN 2017 NË AGJENCINË E TRAJTIMIT TË PRONËS

Agjencia e Trajtimit të Pronave në zbatim të ligjit 133/2015 dhe pikës 15 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 221, datë 23.3.2016, “Për mënyrën e funksionimit dhe organizimit të Agjencisë së Trajtimit të Pronës”, paraqet raportin periodik me të dhënat e përcaktuara në këtë vendim.

A. TË PËRGJITHSHME PËR ECURINË E VLERËSIMIT FINANCIAR TË VENDIMEVE PËRFUNDIMTARE, QË KANË NJOHUR TË DREJTËN E KOMPENSIMIT, SI DHE ECURINË E EKZEKUTIMIT TË KËTYRE VENDIMEVE, DUKE PËRGJITHËSUAR TË DHËNAT PËR SIPËRFAQEN E KOMPENSUAR SIPAS LLOJIT TË PASURISË, NUMRIN E TYRE DHE VLERËN MONETARE TË SHPËRNDARË;

Agjencia e Trajtimit të Pronës ushtron aktivitetin e saj në zbatim të Ligjit nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” dhe Akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

ATP-ja, brenda afatit 6-mujor nga dita e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 133/2015, ka publikuar regjistrin e të gjitha vendimeve që njohin të drejtën e kompensimit të pronës së subjekteve të shpronësuar, i cili është bërë publik në faqen zyrtare të ATP-së, në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare dhe në media.


1.a.ATP ka vijuar me vlerësimet financiare të vendimeve përfundimtare të cilat kanë njohur të drejtën e pronës për kompensim për vitet 1993, 1994, 1995 dhe 1996 për të gjithë Republikën e Shqipërisë, në përputhje me përcaktimet ligjore ku brenda afatit 3-vjeçar nga hyrja në fuqi e ligjit nr.133/2015, ATP-ja, vlerëson vetëm financiarisht, të gjitha vendimet përfundimtare të pavlerësuar që kanë njohur të drejtën e kompensimit. Prioritet për vlerësimin financiar do të kenë vendimet përfundimtare në rend kronologjik, duke filluar nga vendimi më i hershëm.

Vlerësimet financiare të vendimeve përfundimtare për vitet 1993, 1994, 1995 dhe 1996 përditësohen dhe publikohen vazhdimisht në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare si dhe në faqen zyrtare të internetit www.atp.gov.al.

- Në regjistrin e publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare **nr. 16 datë 30.05.2016**, të përditësuar, janë publikuar gjithsej **4038 vendime të viteve 1993-1994** që kanë njohur të drejtën e pronës për kompensim, nga të cilat 118 vendime janë publikuar në vitin 2017.
- Në regjistrin e publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare **nr. 14 datë 08.05.2017**, të përditësuar, janë publikuar gjithsej **6941 vendime të vitit 1995** që kanë njohur të drejtën e pronës për kompensim.
- Në regjistrin e publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare **nr.41 datë 18.12.2017**, janë publikuar gjithsej **4 877 vendime të vitit 1996** që kanë njohur të drejtën e pronës për kompensim.

Pra, ATP ka vlerësuar gjithsej **15856 vendime të viteve 1993, 1994, 1995 dhe 1996**, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit subjekteve të shpronësuar, për të gjithë territorin e

Republikës së Shqipërisë, nga të cilat **11936 vendime janë vlerësuar në periudhën janar-dhjetor 2017.**



- **Për periudhën janar-dhjetor 2017 ka përfunduar shqyrtimi për 183 kërkesa sipas urdhreve të poshtëshënuar:**
 - 1- Me urdhrin nr.64 dt. 17.02.2017 ka përfunduar shqyrtimi për 49 vendime dhe është shpërndarë vlera financiare prej 321,887,564 lekë.
 - 2- Me urdhrin nr.92 dt. 28.03.2017 ka përfunduar shqyrtimi për 47 vendime dhe është shpërndarë vlera financiare prej 724,775,091 lekë.
 - 3- Me urdhrin nr.107 dt. 25.04.2017 ka përfunduar shqyrtimi për 43 vendime dhe është shpërndarë vlera financiare prej 504,650,954 lekë.
 - 4- Me urdhrin nr.209 dt. 10.07.2017 ka përfunduar shqyrtimi për 44 vendime dhe është shpërndarë vlera financiare prej 408,097,446 lekë.
- Sa më sipër vlera financiare e shpërndarë është **1 959 411 055 lekë.**
- Sipërfaqja e shpërndarë nga fondi fizik në dispozicion të ATP-së është 257.5 ha.

Duhet theksuar se, me kuadrin e vjetër ligjor nuk është realizuar asnjëherë më parë kompensim fizik nga fondi i tokës, ndërsa me kuadrin e ri ligjor, ATP ka shpërndarë një fond toke prej **65.9 ha në vitin 2016 dhe 257.5 ha ne vitin 2017**, tokë bujqësore, duke konfirmuar efikasitetin e zbatimit të ligjit të ri për realizimin e procedurave të kompensimit fizik dhe duke ulur në këtë mënyrë detyrimin e shtetit për t'i kompensuar financiarisht këto subjekte.

Për periudhën janar-dhjetor 2017, pranë ATP-së janë paraqitur 881 kërkesa me objekt ekzekutimin e vendimit të vlerësuar financiarisht, për vitet 1993-1995.

2.a.Proçesi i kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale. (ALUIZN-i)

Në zbatim të VKM-së nr. 383 date 19.05.2010 “Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale”, të ndryshuar, si dhe VKM-ve përkatëse në bazë të së cilave

janë miratuar listat e subjekteve përfitues dhe pasurive përkatëse, në Sektorin e Kompensimit Financiar dhe Fizik janë administruar kërkesat e subjekteve për përfitim të kompensimit.

Për periudhën **janar-dhjetor 2017 janë miratuar 8 VKM** për shpërblimin e pronarëve për sipërfaqet takuese të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informate (Nr. 89/2017, Nr. 230/2017, Nr. 367/2017, Nr. 395/2017, Nr. 711/2017, Nr. 712/2017, Nr. 713/2017, Nr. 714/2017).

Në Sektorin e Kompensimit Financiar dhe Fizik për sa i përket shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale, për periudhën **janar-dhjetor 2017 janë paraqitur rreth 852 aplikime** nga subjektet përfitues.

Janë trajtuar me vendime për lëvrimin e fondit të kompensimit, që përfitohet nga shpronësimi i sipërfaqeve të përcaktuara në VKM-të përkatëse, (70% të vlerës së miratuar me VKM), **587** kërkesa për të cilat janë hapur dosjet përkatëse, të cilat u përkasin përafërsisht 1760 subjekteve përfitues.

Për të lehtësuar procedurat e aplikimit për subjektet ATP ka ndërmarrë iniciativën për ndryshimin e VKM-së nr. 223/2015 e cila ka ndryshuar me VKM-në nr. 685 datë 28.09.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 223 datë 23.03.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”.

3.a.Kompensimi me kërkesa të veçanta

Gjatë vitit 2017 Agjencia e Trajtimit të Pronave ka kryer kompensim financiar (kompensimi progresiv 20 %, 30% dhe 40%), referuar nenit 17 të ligjit 133/2015. me kërkesa të veçanta për 12 aplikime.

Vlera totale për **12 aplikime** me kërkesa të veçanta është 348 631 590 lekë.

Sipas kompensimit progresiv 20%, 30% dhe 40% subjektet kanë përfituar kompensim financiar **me vlerë 97 434 259 lekë.**

Për aplikimet e mësipërme buxhetit të shtetit i kursehet një shumë prej 251 197 331 lekë.


B. PËR NUMRIN E KËRKESAVE TË PARAQITURA NGA SUBJEKTET E SHPRONËSUARA TË NDARA SIPAS QARKUT DHE NË SHKALLË VENDI SI DHE PËR LLOJIN E PASURISË SË PRETENDUAR;

Në zbatim të ligjit 133/2015, “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave”, dhe VKM-së nr. 222, datë 23.02.2016, “Për trajtimin e kërkesave për njohje të pronës e të kompensimit të saj” Drejtoria e Trajtimit të Kërkesave për Njohje Pronësie në ATP ka punuar dhe ka përmbushur detyrat duke respektuar legjislacionin dhe aktet ligjore në fuqi, si më poshtë:

1.b.Lidhur me kërkesat e trajtuara në Sektorin e Trajtimit të Kërkesave për Njohje Pronësie, janë përmbyllur me vendim 2529 kërkesa për të gjitha qarqet e Republikës së Shqipërisë:

Janë kryer procedura e **kthimit të akteve(praktikat) subjekteve kërkues 2164 kërkesa**, pas njoftimit për plotësim dokumentacioni dhe kalimit të afatit kohor, përcaktuar në ligj dhe aktet nënligjore (VKM 222/2016, si dhe Kodi i Procedurës Administrative).

Janë kryer procedura me **vendimmarrje për 365 dosje ku është vendosur mbyllje e proçedimit** të kërkesës së depozituar nga subjekti kërkues i cili vjen në cilësinë e trashëgimtarit ligjor/përfaqësues me prokurë të subjektit të shpronësuar.




Për një numër relativisht të madh dosjesh është bërë vlerësimi paraprak i problematikës. Pas kësaj analize, janë përcaktuar saktë dokumentet tekniko ligjor dhe hartografik që mungojnë dhe që janë të nevojshme për procesin e njohjes dhe kompensimit të pronës, për përgatitjen e konfirmimeve ose në rast të kundërt edhe pas marrjes së njoftimit nga subjekti kërkues në cilësinë e trashëgimtarit ligjor/përfaqësues me prokurë, rrëzim të kërkesës.

Gjatë kësaj periudhe janë pritur dhe janë sqaruar përfaqësuesit e subjekteve të shpronësuar, të cilët janë orientuar për të plotësuar dosjet e tyre me dokumentacionin e nevojshëm për zgjidhjen e drejtë të çështjeve.

Gjithashtu është kryer kthim përgjigje subjekteve kërkues dhe institucioneve zyrtare me objekte të ndryshme në kërkesat e tyre.

2.b. Janë të administruar pranë këtij sektori gjithsej 9523 dosje të cilat nuk janë përmbyllura me vendim përfundimtar, të ndarë sipas qarqeve:

Nr.rendore	Numri i dosjeve sipas qarqeve
1	· Q. Berat – 244
2	· Q. Dibër – 30
3	· Q. Durrës – 1189
4	· Q. Elbasan – 304
5	· Q. Fier – 883
6	· Q. Gjirokastrë – 735
7	· Q. Korçë – 940
8	· Q. Kukës – 53
9	· Q. Lezhë – 352
10	· Q. Shkodër – 1337
11	· Q. Tiranë – 1577
12	· Q. Vlorë – 1879



3.b. Gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesave janë evidentuar problematikat më të shpeshta gjatë Trajtimin të Kërkesave për Njohje nga ana e subjekteve për marrjen e dokumentacionit për **qarqet Vlorë, Fier, Gjirokastrë**, rezulton:

- Qarku Vlorë konkretisht rrethi Sarandë, Delvinë kanë problematik marrjen e vërtetimeve kadastrale dhe hipotekore pranë organeve përkatëse për shkak se në këtë rreth ZVRPP Sarandë është djegur në vitin 1997, ndërsa zyra e kadastrës Sarandë është vjedhur në vitin 2009.
- Qarku Fier duke përfshirë këtu dhe rrethin Mallakastër kanë të njëjtën problematikë në lidhje me marrjen e dokumentacionit të vjetër ligjore pasi ZVRPP e Fierit është djegur në vitin 1997.
- Qarku Gjirokastrë përfshin këtu rrethin Tepelenë ka të njëjtën problematikë për marrjen e dokumentacionit të vjetër hipotekor pasi ZVRPP Gjirokastrë nuk jep informacion.
- Në të tre qarqet procesi i azhurnimit për regjistrimin e pronës në hipotekë nuk ka përfunduar duke sjellë mungesën e informacionit për statusin juridik të pronës së pretenduar si dhe mos plotësimin e dokumentacionit hartografik nga qytetarët.

Për sa i përket problematikave të hasura nga ana e subjekteve për marrjen e dokumentacionit për **qarqet Tiranë, Dibër, Elbasan** si më poshtë:

- Qarku Tiranë, subjektet përcjellin fragmente harte apo dokumentacionin hipotekar nga ZVRPP pa vulën njehsuese lidhëse.
- Për të gjitha qarqet, vërtetimet në lidhje me përfitim nga ligji nr. 7501 “për tokën” lëshuar nga ZVRPP apo DAMT, nuk japin informacionin e duhur, sidomos për sa i përket vendndodhjes së pronës së përfitur e cila do na shërbejë për zbatimin e ligjit 133/2015 në lidhje me zbritjen e vlerës së fituar.
- Qarku Dibër dhe qyteti i Librazhdit subjektet depozitojnë dokumentacion ligjor të viteve 1947 apo 1950-1952, gjë e cila na flet pas reformës agrare, kjo ka sjell shqetësim te subjektet duke qenë se nuk arrijnë të gjejnë dokumente të tjerë ligjorë për pretendimin e depozituar për trajtim në ATP.

- Qarku Dibër dhe ai Elbasan, subjektet në shumicën e rasteve nuk arrijnë të marrin fragmente hartë nga ZVRPP përkatëse, pasi këto zona nuk janë të hedhura në sistemin e ZVRPP-së, si pasojë ka pengesë si për subjektin kërkues dhe për ATP në marrjen e konfirmimeve.

Për sa i përket problematikave të hasura nga ana e subjekteve për marrjen e dokumentacionit për qarqet Durrës, Korçë, Berat, si më poshtë:


- Në rastet kur prona është në bashkëpronësi kërkohet të trajtohet për njërin bashkëpronar sipas rastit, pasi për bashkëpronarët e tjerë nuk mund të sigurojnë informacion apo dokumentacion.

C. PËR NUMRIN E KËRKESAVE TË SHQYRTUARA, INDEKSIN E SAKTË TË ÇËSHTJEVE TË PRANUARA APO TË RRËZUARA NË ATP, SI DHE PËR NUMRIN E ÇËSHTJEVE TË NDJEKURA E TË ANKIMUARA NË GJYKATË;

Mbrojtja e interesave të ATP në tre shkallët e gjyqësorit dhe në gjykatën Administrative për vendimet e dhëna ndër vite, bazuar në legjislacionin në fuqi, për vitin kalendarik 1 janar 2017 deri në 31.12.2017 janë ndjekur si me poshtë:

Padi të depozituara për Gjykatwn e Rrethit Gjyqwsor Tirane, Gjykatat e Rretheve Gjyqesore,

Nr	Padi të depozituara	Numri
1	Apeli Civil dhe Gjykatat Administrative shkalle e pare dhe Apel	856
2	Ankime pranë gjykatave të apelit Tiranë dhe Rrethe	86
3	Rekurse pranë gjykatës së lartë	111
4	Vendime me shpallje mos competence lendore	86
5	Kthim aktesh	10
6	Pezullim gjykimi	6
7	Pushim gjykimi	22



Ç. Në lidhje me fondin e tokës që është shpërndarë me kompensim nga ATP-ja;

Në zbatim të Ligjit nr.133/2015 për “*Trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave*” dhe VKM nr.223 datë 23.03.2016 “*Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave*”:

1.ç. Nga Drejtoria e Kompensimit në ATP janë ndjekur procedurat ligjore edhe për procesin e kompensimit fizik

- Për periudhën **janar – mars 2017**, janë trajtuar me **kompensim fizik** nga fondi i tokës në dispozicion të ATP-së 11 kërkesa (nga 96 kërkesa) sipërfaqja e përfituar është 1 221 202.96 m². (**122.1 ha**), e vlerësuar financiarisht 269 478 816 lekë.
- Për periudhën **prill – qershor 2017**, janë trajtuar me **kompensim fizik** nga fondi i tokës në dispozicion të ATP-së **6 kërkesa**, sipërfaqja e përfituar është **124.8 ha**, e vlerësuar financiarisht 230 252 266 lekë.
- Për periudhën **korrik – shtator 2017**, janë trajtuar me **kompensim fizik** nga fondi i tokës në dispozicion të ATP-së **5 kërkesa**, sipërfaqja e përfituar është **10.58 ha**, e vlerësuar financiarisht 23 065 423 lekë.

Gjatë vitit 2017; Sipërfaqja e shpërndarë nga fondi fizik në dispozicion të ATP-së është 257.5 ha.

Në zbatim të ligjit 133/2015, “*Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave*”, dhe VKM-së nr.222 datë 23.02.1016, “*Për trajtimin e kërkesave për njohje të pronës e të kompensimit të saj*”, urdhrit nr.87 date 17.5.2016 “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Trajtimit të Pronës*”, Sektori i Verifikimit të Kërkesave për Njohje për vitin 2017 ka proceduar dhe:

2.ç. Janë kryer verifikimin në terren për 20 dosje të cilat i kalojnë 40 kërkesa (*drejtuar institucioneve të treta*), që i përkasin kompensimit fizik për subjektet që kanë aplikuar në Sektorin e Kompensimit duke përfituar nga Fondi i Tokës që ka ATP në dispozicion për kompensimin fizik të subjekteve përfitues.

Duhet theksuar se, me kuadrin e vjetër ligjor nuk është realizuar asnjëherë më parë kompensim fizik nga fondi i tokës, ndërsa me kuadrin e ri ligjor, ATP ka shpërndarë një fond toke prej 65.9 ha në vitin 2016 dhe 257.5 ha ne vitin 2017 , tokë bujqësore, duke konfirmuar efikasitetin e zbatimit të ligjit të ri për realizimin e procedurave të kompensimit fizik dhe duke ulur në këtë mënyrë detyrimin e shtetit për t’i kompensuar financiarisht këto subjekte.

D. PËR PUNËN E KOMISIONIT NDËRINSTITUCIONAL PËR IDENTIFIKIMIN E PRONËS SHTETËRORE QË MUND TË KALOJË NË FONDIN E KOMPENSIMIT TË PRONAVE DHE PËR PRONËN SHTETËRORE TË IDENTIFIKUAR PREJ KOMISIONIT PËR TË KALUAR NË FONDIN E KOMPENSIMIT TË PRONAVE, DUKE SPECIFIKUAR SIPËRFAQEN E IDENTIFIKUAR, LLOJIN E PASURISË DHE VENDNDODHJEN E SAJ;

- Në zbatim të VKM nr.901 dt.21.12.2016 "Për ngritjen e Komisionit Ndërinstitucional për identifikimin e pronës shtetërore që mund të kalojë dhe të bëhet pjesë e fondit të tokës për kompensimin e pronave" është zhvilluar takimi i parë i Komisionit Ndërinstitucional në datën 17.01.2017 dhe ka vijuar puna për zbatimin e detyrave e përcaktuara prej tij.
- Është ngritur grupi i punës me urdhër nr.56 dt.16/02/2017 ku ATP në rolin e sekretariatit teknik të Komisionit Ndërinstitucional pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave, po ndjek zbatimin e detyrave të përcaktuara sipas vkm 901/2016.
- Agjencia e Trajtimit të Pronave në rolin e sekretariatit teknik me shkresën nr.prot nr.1192 dt.06.02.2017 "Kërkesë për bashkëpunim" është drejtuar institucioneve të përfshira në proces të cilat janë MZHETTS, MBZHRAU, MPB, MB, MM, për vënie në dispozicion të informacionit për pronat, pjesë e listës së inventarit të tyre, si dhe për pronat që janë nxjerrë jashtë funksionit(shkresë në të cilën është saktësuar qartë dhe afati përfundimtar i dhënies së informacionit).
- Është dërguar informacion nga MZHETTS si dhe Ministria e Mbrojtjes


Ministria e Zhvillimit Ekonomik,Turizmit,Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ka dërguar informacion në rrugë elektronike dhe shkresore duke përcjellë listën e objekteve:

- Listën e objekteve të propozuara për privatizim nga institucionet administruese (1570 objekte).
- **Listën e objekteve në proces privatizimi (568 objekte).**

Tabela me numrin e objekteve

QARKU	Berat	Kukës	Elbasan	Korçë	Lezhë	Tiranë	Gjirokastrë	Fier	Shkodër	Dibër	Durrës	Vlorë
	36	19	121	28	12	122	23	53	54	9	39	52

Grafiku i objekteve sipas qarqeve të paraqitura për kompensim fizik.



Nga Agjencia e Trajtimit të pronave për ecurinë e procedurave dhe zbatimin e detyrave të Komisionit Ndërinstitucional është përgatitur Raportimi dhe është përcjellë zyrtarisht kryetarit të Komisionit Ndërinstitucional si dhe draft axhenda për procedim të mëtejshëm.

Mbështetur në faktin se me VKM 901 datë 21.12.2016 “Për ngritjen e Komisionit Ndërinstitucional për identifikimin e pronës shtetërore që mund të kalojë dhe të bëhet pjesë e fondit të tokës për kompensimin e pronave” në të cilin përcaktohet se Komisioni Ndërinstitucional kryesohet nga zv/kryeministri me përfaqësim në nivel zëvendësministri të MD, MZHU, MZHETTS, MM, MB, M. Mjedisit, M. e Brendshme, në kuadrin e ndryshimeve të strukturës së kabinetit qeveritar, ATP mbetet në pritje të vijimit të procedurave; referuar raportit të paraqitur dhe draft axhendës pranë ish-zëvendëskryeminitrit.

DH. PËR NIVELIN E BASHKËPUNIMIT ME INSTITUCIONE TË TJERA.

Agjencia e Trajtimit të Pronave në funksion të procesit të njohjes dhe kompensimit të pronës, bashkërendon veprimtarinë me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencinë e Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave dhe Ndërtimeve Informate, Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, Avokaturën e Shtetit, Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjë hapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, organet e pushtetit vendor dhe çdo institucion tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi për këtë proces.

1.dh. Nga ATP janë ndjekur me institucionet e treta ecuria për të përmbyllur procedurën e Shpalljeve Publike për njoftimin e subjekteve për pjesëmarrje në procedim administrativ për rreth 816 dosje:

- Është kryer procedura e konfirmimeve për rreth 400 dosje të cilat i kalojnë 1300 kërkesa (drejtuar institucioneve të treta), në rastet kur dokumentacioni ligjor/hartografik i administruar nga subjekti kërkuar ka paraqitur mangësi ose kur është i nevojshëm plotësimi i tij, në institucionet përkatëse që e kanë lëshuar atë.
- Janë dërguar kërkesa për konfirmime në zbatim të VKM-në nr.770, datë 12.11.2014 “Për Kalimin në Fondin e Kompensimit Fizik, në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (sot Agjencia e Trajtimit të Pronave), drejt institucioneve përkatëse të Qarkut Elbasan, përkatësisht:

Nr.rendore	Konfirmime
1	· ZVRPP Elbasan, kerkese per 357 Numra Pasurie.
2	· ZVRPP Lbrazhd, kerkese per 1452 Numra Pasurie.
3	· ZVRPP Prenjas, kerkese per 18 numra pasurie
4	· ZVRPP Gramsh, kerkese per 18 Numra Pasurie.
5	· Bashkia Librazhd, kerkese per 879 Numra Pasurie.
6	· Bashkia Gramsh, kerkese per 9 Numra Pasurie.
7	· Bashkia Elbasan, kerkese per 174 Numra Pasurie.
8	· Bashkia Cerrik, kerkese per 33 Numra Pasurie.
9	· Bashkia Belsh, kerkese per 150 Numra Pasurie.

- Kërkesat konsistojnë:
 - 1- Nëse pasuritë janë trajtuar sipas ligjit Nr. 7501, datë 19.07.1991.
 - 2- Statusi juridik i pasurive.(sipas listës bashkëlidhur)
 - 3- Vënien në dispozicion të kopjes së kartelave të pasurive për çdo numër pasurie me ndryshimet përkatëse.

4- Bllokimin e pasurive në favor të Agjencisë së Trajtimit të Pronave. Nga institucionet e Qarkut Elbasan kanë ardhur përgjigjet dhe konfirmimet përkatësisht:

- ZVRPP Elbasan, kthim përgjigje për 25 Numra Pasurie.
- ZVRPP Gramsh, kthim përgjigje për 15 Numra Pasurie.
- Bashkia Gramsh, kthim përgjigje për 6 Numra Pasurie.

2.dh.Për Trajtimi i kërkesave për Tjetërsim të Sipërfaqeve Shtetërore, është bashkëpunuar me të gjitha institucionet shtetërore të përcaktuar në ligj.

Spektori i Tjetërsimit të Sipërfaqeve Shtetërore për vitin 2017, ka shqyrtuar, monitoruar dhe zbatuar procedurat ligjore sipas VKM nr. 578 datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”, ndryshuar me VKM nr. 790 datë 14.11.2012. Për një ndryshim në vendimin nr. 578, datë 29.08.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”

- Spektori i tjetërsimit të sipërfaqeve shtetërore për vitin 2017, ka patur si objektiv që të trajtojë me vendimmarrje **250 kërkesa** të subjekteve të ndryshme.
- Gjatë kësaj periudhe, pra nga janari 2017 deri më datën 15.12.2017 kanë aplikuar pranë institucionit tonë **151 subjekte nga Bashki të ndryshme**.
- Ndërkohë, për periudhën Janar 2017 deri më datën 08.09.2017, kemi trajtuar dhe konkluduar me vendimmarrje **167 kërkesa**, rreth **93 verifikime** si edhe rreth **815 kërkesa drejtuar institucioneve të treta**. Ju bëjmë me dije se ka qënë ky shkak, pra krijimi i vakumit si rezultat i largimit të drejtuesit të institucionit që nuk u realizua numri i vendimmarrjes.
- Duke qënë se një numër shumë i madh dosjesh janë të hapura nga ish Z.R.K.K.Pronave në Qarqe dhe datojnë që nga viti 2009 e në vijim, subjekte të shumta nuk janë interesuar pranë ATP – së për dosjet e tyre pra pothuajse e kanë braktisur procesin. **Të gjendur përpara këtij fakti, ne kemi bërë pothuajse për të gjitha këto dosje rilajmërimet dhe për ato subjekte që nuk kemi adresë të saktë, në bazë të Kodit të Procedurës Administrative, kemi proceduar me shpallje publike pranë Bashkive përkatëse.**

Theksojmë se trendi i përpunimit të dosjeve (pra dalje të tyre me vendimmarrje) në raport me hyrjen (pra hapje e dosjeve të reja), është arritur të jetë pozitiv, pra ka më shumë dalje se sa hyrje.

3.dh.Bashkëpunim si dhe raportim sipas detyrimeve ligjore me institucionet :

- DAP/ASPA (Raportime të herëpashershme, trajnime si dhe plotësimi i sistemit elektronik të punonjësve)
- ILDPKI (Raport vjetor, komunikim i vazhdueshëm lidhur me deklaratat e vetëdeklarimit , udhëzuesit etj)
- Ministria e Drejtësisë (komunikim i vazhdueshëm në rrugë elektronike dhe shkresore lidhur me Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse)

4.dh. Bashkëpunim dhe raportime periodike institucioneve të pasqyruar në tabelë;

RAPORTIME INSTITUCIONALE				
Nr	Emertimi i Institucionit Raportues	Baza ligjore	Periudha e raportimi	Menyra e raportimit
RAPORTIME PERIODIKE				
1	Kuvendit të Shqiperise Kom.Parl. per Ceshtjet Ligjore, Admin.Publike dhe te Drejten e Njeriut	ji nr.133/2015, neni 26/	cdo vit	me shkrim(ose goje)
				(raport ne kuven kur i kerko
2	Kuvendit te Shqiperise Komisionit te Perhershëm Parlamentar per Ekonomine dhe Finace	VKM 221/2016, pika 14	cdo tre muaj	me shkrim
3	Kryeministrit	VKM 221/2016, pika 14	cdo tre muaj	me shkrim
4	Ministrit te Drejtesise (raport per aktivitetin e ATP)	VKM 221/2016, pika 14	cdo tre muaj	me shkrim
5	Komisioni Nderinstitucional "per identifikimin e prones shteteshme qe mund te kalojne si pjese e fondit te tokes"	ligji 133/2015 neni 26/p3 VKM nr.901/2016	ATP sekretariat teknik	raportim periodik kur kerkohet nga komisioni!
6	Zyres Operacionale e Situates(ZOS) prane Kryeministrit		cdo muaj	sipas formatit te ZOS (te kerkohejn ndrysh.indika
7	Grupit Nderinstitucional të Punës për Integrimin Europian (GNPIE) për Kapitullin "Kriterin Politik" dhe "Kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore"		cdo muaj	takim prane MD
8	Raportim Drejtorit te Pergjithshem te ATP (raportim sektorial)	VKM 221/2016 pika 11	cdo muaj	Me shkrim
RAPORTIME PER DO KUMENTA STRATEGJIK				
1	Raportim per implementimin e Plan Veprimit per vendimin e Manu	VKM	kerkohet MD dhe AS	me shkrim
2	Per zbatimin e Marreveshjes se Stabilizim Asocimit Komiteti i Stabilizim Asocimit , MD	okumenta te Partneritetit Evropian (2007)	per periudhen qe kerkohet	me shkrim
3	Ministrise se Drejtesise dhe MEPJ Informacion lidhur me lirene e besimit dhe komunitete fetare	Raportuesi Special illit të të Drejtave të Njeriut	periudha qe kerkohet	me shkrim
4	Raportime në kuadër të nenkomitetit te Drejtesise, Lirise dhe Siguri Grupi Nderinstitucional te Punes GNPIE prane MD	MD dhe Grupit te Punes	periudha qe kerkohet	me shkrim
			(javore, mujore, 6-mujore, vjetore	
5	Projektit "Mbeshtetja e mjeteve te brendshme per zbatimin efektiv te vendimeve te GjEDN Grup pune nga ATP		sipas planit te punes	te takimet e programuar
6	Planit të Veprimit të Strategjisë Nder-Sektoriale Kundër Korrupsion Minsitrise se Drejtesise	Grup Pune(e.lala)	cdo 6 muaj	Me shkrim
7	Raportime per Nenkomitetin per "Ekonomi, Financë dhe Statistike"	Sektoriale	kur kerkohet nga MD	me shkrim

E. PËR ÇDO ÇËSHTJE TJETËR, SIPAS VLERËSIMIT TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM, DUHET TË VIHET NË DIJENI KRYEMINISTRI DHE/APO KOMISIONI PËRKATËS I KUVENDIT.

1.e.Sistemi Web-GIS

Agjencia e Trajtimit të Pronave në zbatim të Ligjit 133/2015, Neni 32/6 ka si detyrim të dixhitalizojë informacionin hartografik të vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit. Agjencia përmes një fondi të akorduar nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve me vendimin Nr. 33, datë 2015/07/15, po punon me sistemin WEB_GIS .

Për sa i përket sistemit WEB_GIS janë realizuar fazat e tij me sukses. Nëpërmjet këtij sistemi po realizohet standardizimi dhe informatizimi i të gjithë procesit që do të ndiqet për trajtimin e kërkesave për njohje pronësie, standardizimi dhe unifikimi i informacionit hartografik i përfshirë në këtë proces, finalizohet identifikimi i faturës së saktë të kompensimit që shteti u detyrohet pronarëve, do të garantojë një proces të paanshëm, transparent ku çdo qindarkë e buxhetit të shtetit apo fond fizik pronësor shtet do të mund të shpërndahet duke mënjanuar abuzimet në këtë proces. Ky sistem, ndër të tjera, është parashikuar të ndërveprojë dhe të ndajnë informacion me sistemet e tjera tashmë operative (p.sh. sistemi i ZRPP, Departamenti i Gjendjes Civile, Qendra Kombëtare e Regjistrimit, etj) ASIG ETJ.

Sistemi i Web-Gis-it është një sistem funksional i cili mundëson përllogaritjen e faturës financiare për kompensim.

Aktualisht sistemi i Web-Gis-it, nëpërmjet vlerësimit të vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën për kompensim, bën pozicionimin përfundimtar të këtyre vendimeve, duke nxjerrë një faturë të pastër financiare për kompensim për vendimet e viteve 1993-1996.

Për periudhën 2017, me sistemin Web Gis sipas kontratës së mirëmbajtjes janë kryer këto shërbime nga kompania **COMMUNICATION PROGRESS SH.P.K**:

- Mirëmbajtje databaze ATP
- Monitorim i faqes web- gis kur nuk aksesohet nga interneti
- Suport për skanim dhe sistemim dosjesh në arkivën e ATP-së gjatë 2017
- Kufizimi i të drejtave të juristeve/hartografeve tek vlerësimet ekonomike të dosjeve jo përgjegjës

I gjithë aktiviteti, i dokumentuar raportohet periodikisht sipas kushteve të implementimit të projektit dhe monitorohet nga një grup(specialist TI) në përputhje me kërkesat e parashikuara në marrëveshjen e shërbimeve të mirëmbajtjes, e cila vazhdon këtë proces mirëmbajtje deri në dhjetor 2020.

2.e. Bashkëpunim me ADISA dhe AKSHI n për shërbimet qeveritare elektronike

2. e.1.*Për efekt përputhshmërie të akteve tip, urdhra, me qëllim unifikimin e praktikave të dala nga ATP. Janë ndjekur procedurat ligjore të implementimit të projekteve të AKSHI-it dhe ADISA. Në zbatim të urdhërit nr.262 dt 30.10.2017 “Për ngritjen e grupit të punës **për hartimin dhe validimin e kartelave Informative të Shërbimeve** që ofron për qytetarët, Agjencia e Trajtimit të Pronave është kryer validimi i shërbimeve të kartelave informative dhe përgatitja e formularëve si dhe hartimi i listës së shërbimeve që ATP-ja ju ofron qytetarëve.*

2. e.2.*Në kuadrin e implementimit të projektit për shërbimet elektronike në ATP dhe ADISA janë ndjekur hap pas hapi procedurat në bashkëpunim me AKSHI-in, në kuadrin e projektit “Shtimi i 209 shërbimeve të reja elektronike për 18 institucione”*

Shërbimet e reja elektronike të ofruara nga institucioni ATP-së u bënë publike në portalin qeveritar E-albania dhe mund të aksesohen sipas link-eve të mëposhtëm:

1. Ankesë dhe trajtim i dosjes me specialistin përkatës pranë ATP:
<https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=12412>

2. Kërkesë për statusin dhe problematikat e shqyrtimit të dosjes:
<https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=12413>

2.e.3. Është ndjekur procedura për bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet ATP, ADISA dhe AKSHI për trajnimin e stafit të ATP “si përdorues të Portalit Qeveritar për gjenerim dokumentacioni, certifikata”. Për punonjësit e trajnuar të Agjencisë së Trajtimit të Pronave u krijuan llogaritë e tyre në modulën “ONE STOP SHOP për nëpunësit e administratës publike”. Secili prej punonjësve që merret me procedurat e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve mund të aksesojnë modulën me kredencialet si më poshtë:

Username: emër.mbiemër (të gjitha shkronja të vogla)

Password: P@ssword123 (pas hyrjes në modul mund të ndryshoni passëord)

3.e. Raportime periodike pranë Zyrës Operacionale për Situata (ZOS)

3. e.1. Raportim periodik mujor për indikatorët e performancës së ATP

Në kuadër të punës për menaxhimin e informacionit për raportimin periodik të kërkuar nga Zyra Operacionale e Situatës (ZOS) në Kryeministri, për indikatorët e performancës që i përkasin institucionit të ATP, është bashkëpunuar me sektorët përkatës brenda ATP-së dhe është kryer raportimi sipas formatit të kërkuar dhe tabelës përkatëse;

- *Raportimi pranë ZOS mbi indikatorët për shërbimet ndaj qytetarëve 2017*

Informacioni është paraqitur në formë table dhe grafike për mënyrë krahasimore, sipas 12 indikatorëve të pasqyruar në tabelën si më poshtë.

Tabela e indikatorëve të raportuar në ZOS për shërbimet ndaj qytetarëve në ATP

Indikatori	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Totali
Aplikime të plota	744	743	873	1165	1225	840	507	916	747	681	7760
Aplikime të paplota	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Aplikime të mbartura	80	76	55	25	20	70	154	101	640	38	1221
Total i shërbimeve të levruara	938	623	759	1287	1124	1700	503	349	1223	428	8506
Shërbime të levruara brenda afatit	792	449	586	926	877	1494	134	199	251	224	5932
Shërbime të levruara jashtë afatit	146	174	173	361	247	206	369	150	972	204	3002
Plotesim dokumentacioni	4	10	16	16	57	28	45	49	77	71	373
Ankesa të reja	7	15	16	30	27	10	31	13	5	5	159
Ankesa të mbartura	1	0	3	2	4	3	2	10	22	7	54
Nr. përgj. i ankesave të zgjidhura/shqyrtuara	8	12	17	28	28	11	23	1	20	6	154
Nr. ankesash të zgjidhura/shqyrtuara brenda afatit	7	10	13	24	23	8	20	0	1	4	110
Nr. ankesash të zgjidhura/shqyrtuara jashtë afatit	1	2	4	4	5	3	3	1	19	2	44

Paraqitja grafike e indikatorëve për periudhën që raportohet;







Tabela e detajuar e aplikime në ATP për periudhën janar-nëntor 2017 & grafike

Indikatori	Shkur t	Mar s	Pril l	Maj	Qersho r	Korri k	Gush t	Shtato r	Teto r	Nento r	TOTAL I
Aplikime nga ALUIZNI	136	79	89	167	92	37	31	34	49	23	737
Aplikime prane sektorit te Oborreve	25	13	14	21	6	10	5	12	20	9	135
Aplikime prane sektorit te Shqyrtimit	44	67	71	80	32	29	7	26	10	19	385
Aplikime prane sektorit te kompensimit	25	36	20	107	180	113	69	70	119	85	824
Aplikime per sherbime pa vendimmarje	514	548	679	784	912	650	392	773	544	545	6341
Aplikime per Kompensim progresiv				6							6
Aplikime per kerkesa te vecanta					3	1	3	1	5		13
Totali per cdo muaj	744	743	873	1165	1225	840	507	916	747	681	8441





- *Raportimi pranë ZOS mbi indikatorët; hartografim dhe skanim të vendimeve .*

Për periudhën Janar – Nëntor 2017 (muaji dhjetor do të raportohet në datën 10 të muajit pasardhës) Agjencia e Trajtimit të Pronave ka raportuar 1246 skanime dhe 3853 hartografime, informacion që përpunohet nga inspektorët e sektorit WEB-GIS dhe TI. Për konstatimet e bëra nga raportimet periodike gjatë vitit 2015, 2016, 2017 dhe nga analizimi i indikatorëve të cilët raportohen periodikisht, janë zhvilluar takime me ekspertë të implementimit të projektit Web-Gis; dhe janë diskutuar çështje të ndryshme teknike.

Raportohen në mënyrë periodike mujore indikatorin e ATP ;

> “Numri i vendimeve **të skanuar** në regjistrin elektronik të vendimmarrjes së AKKP-së nga viti 1993 deri në ditët e sotme (%) raportimi në tabelë”

> “Numri i vendimeve për kthimin dhe kompensimin e pronave **të hartografuara (%)**” pranë ZOS.

Agjencia e Trajtimit të Pronave ndjek te gjitha procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” duke vënë në zbatim dhe programin e transparences.

BAZA LIGJORE ATP:

Agjencia e Trajtimit të Pronës ushtron aktivitetin e saj në zbatim të Ligjit nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” dhe Aktve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Ligji nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” është miratuar nga Parlamenti në datë 5 Dhjetor 2015 dhe u botua në Fletoren Zyrtare në datë 08.02.2016.

Në mbështetje të implementimit të Ligjit nr.133/2015 janë miratuar një sërë aktesh:

1. VKM nr.221 datë 23.03.2016, “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të ATP-së”.

2.VKM nr.222 datë 23.03.2016 ,“Për trajtimin e kërkesave për njohje të pronës dhe kompensimit të saj”

Me vendim nr.1, datë 16.01.2017 Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar si antikushtetues nenin 6, pika 3 dhe pika 5 të Ligjit nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”.

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka kryer procedurën për ndryshimin e VKM nr.222 /2016 për pjesën që preket nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese, duke dërguar draftin me propozime për ndryshim në Ministrinë e Drejtësisë.

3.VKM nr.223 datë 23.03.2016, “Për përcaktimin e rregullave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”

Për të lehtësuar procedurat e aplikimit për subjektet ATP ka ndërmarrë iniciativën për ndryshimin e VKM-së nr. 223/2015 e cila ka ndryshuar me VKM-në nr. 685 datë 28.09.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 223 datë 23.03.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”.

- Ne mbledhjen e fundit me VKM me nr 765, nr.766, janë bërë ndryshime në VKM 222/2016,dhe 223/2016

4. VKM nr.901 datë 21.12.2016 “Për ngritjen e Komisionit Ndërinstitucional për identifikimin e pronës shtetërore që mund të kalojë dhe të bëhet pjesë e Fondit të Tokës për kompensimit të pronave”.

Përgatiti:

Spektori i Asistencës Ligjore dhe Projekteve

Ervehe Çumani, Përgjegjës Spektori

